

"FC DRITA" SH.P.K.

Gjilan, Kosovë

Numri unik 811186974

**PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT PER VITIN
QE PERFUNDON ME 31 Dhjetor 2019**

Mars 2020

Përmbajtja

Faqe

i

RAPORTI I AUDITORIT TE PAVARUR

1

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2019

2

Pasqyra e të ardhurave përbledhëse për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

3

Pasqyra e Rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

4

Pasqyra e ndryshimeve ne Ekuitet që përfundon më 31 Dhjetor 2019

5 – 19

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët: "FC DRITA" SH.P.K., Gjilan

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë "FC DRITA" SH.P.K., të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2019, Pasqyrën e të Ardhurave, Pasqyrën e Ndryshimeve në Ekuitet dhe Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin e përmbyllur dhe të shënimëve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financier të "FC DRITA" SH.P.K. me 31 Dhjetor 2019, dhe rezultatin e aktivitetit të saj për fundin e vitit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi IESBA) dhe kemi përbushur përgjegjësitë tjera etike nëpërputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM, dhe për kontrollet të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërinë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidoj shoqërinë apo të ndërpres operimin apo nuk ka ndonje alternative tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilë janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arësyeshme mund të pritet të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimit në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e gabimeve materiale në pasqyrat finnaciare, për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të gabimeve materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretim, apo shkelje të kontolleve të brendshme.


- I kuptojmë kontrolllet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontolleve të brendshëm të Shoqërisë.

- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti

- Konkuludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdimesisë së kontabilitetit nga menagjmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsidereueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi te detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tillë janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, çasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrolllet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Fahri Breznica, Auditor Ligjor


"Auditim&Kontabilitet"
10000, Prishtine,Kosovë



Date 18.03.2020

“FC DRITA”SH.P.K

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Eur)

| | Shënimë | 2019 | 2018 |
|---|---------|-----------------|-----------------|
| Pasuritë | | | |
| Pasuritë afatshkurterë | | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 4 | 11,059 | 460,488 |
| Llogarite e arketueshme | 5 | 3,600 | 5,450 |
| Huazimet e dhena | 6 | <u>112,500</u> | <u>15,000</u> |
| Gjithsej pasuritë afatshkurtra | | <u>127,159</u> | <u>480,938</u> |
| Pasuritë afatgjata | | | |
| Ndertese, makineri dhe paisje | 7 | <u>3,033</u> | <u>4,433</u> |
| Gjithsej pasuritë afatgjata | | <u>3,033</u> | <u>4,433</u> |
| Gjithsej pasuritë | | <u>130,192</u> | <u>485,371</u> |
| Detyrimet dhe Ekuiteti | | | |
| Detyrimet | | | |
| Detyrimet afatshkurterë | | | |
| Llogarite e pagueshme | 8 | 17,280 | 1,409 |
| Detyrimet e tatimit | 9 | 3,925 | 8,790 |
| Te hyrat e shtyra | 10 | <u>48,987</u> | <u>476,105</u> |
| Detyrimet tjera afatshkurta | 11 | <u>40,000</u> | <u>0.00</u> |
| Gjithsej detyrimet afatshkurtra | | <u>110,192</u> | <u>486,304</u> |
| Detyrimet afatgjata | | | |
| Gjithsej detyrimeve afatgjata | | <u>0</u> | <u>0</u> |
| Gjithsej detyrimet | | <u>110,192</u> | <u>486,304</u> |
| Ekuiteti | | | |
| Kapitali Themeltar | 1 | 20,000 | 20,000 |
| Fitimet /Humbja e vitit | 17 | <u>20,933</u> | <u>37,565</u> |
| Fitime/Humbjet të mbartura | 17.1 | <u>(20,933)</u> | <u>(58,498)</u> |
| Totali i kapitaleve | | <u>20,000</u> | <u>(933)</u> |
| Totali i detyrimeve dhe kapitaleve | | <u>130,192</u> | <u>485,371</u> |

Pozicioni financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 5 deri 19.

Këto pasqyra financiare u aprovan nga drejtimi i Shoqërisë “FC Drita” më datë 29 shkurt 2020 dhe u firmosën në emër të tij nga:



Drejtori i Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm

Drejtori finansiar

Kontabilisti i certifikuar

“FC DRITA”SH.P.K

Pasqyra e të ardhurave përbledhëse për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat ne Eur)

| | Note | 2019 | 2018 |
|--|------|-----------------|-----------------|
| Te ardhura | 12 | 680,938 | 657,525 |
| Kostoja e sherbimeve | 13 | (84,773) | (179,322) |
| Fitimi buto | | 396,165 | 478,203 |
| Shpenzimet operative | | | |
| Shpenzime e personeli | 14 | (328,536) | (396,858) |
| Zhvleresimi | 7 | (1,400) | (1,400) |
| Shpenzime Administrative | 15 | (21,237) | (21751) |
| Shpenzimet tjera operative | 16 | (24,059) | (20,629) |
| Rezultati nga aktiviteti operativ | | 20,933 | 37,565 |
| Te hyrat tjera | | | |
| Te hyrat nga interesi | | | |
| Shpenzimet tjera interesit | | (0.00) | (0.00) |
| Shpenzimet interesit | | (0.00) | (0.00) |
| Fitimi /Humbja para tatimit | 17 | 20,933 | 37,565 |
| Tatimi mbi fitimi | 17.1 | | |
| Fitimi /Humbja neto I vitit | | 20,933 | 37,565 |

Pasqyra e të ardhurave përbledhëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 5 deri 19.

“FC DRITA”SH.P.K

Pasqyra e Rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

(Vlerat në EUR)

| | 2019 | 2018 |
|---|------------------|----------------|
| Flukse monetare nga aktivitetet operative: | | |
| Parat e arketuara nga konsumatoret | 55,670 | 1,136,960 |
| Parat e paguara furnitoreve dhe te punesuarve | (447,560) | (631,475) |
| Parat e tjera te gjeneruara nga afrizmi | (0.00) | (0.00) |
| Parate neto nga aktivitetet operative | <u>(391,929)</u> | <u>505,485</u> |
| Rrjedha e parase nga aktivitetet investuese | | |
| Blerja e pasurise se patundshme, imantave dhe pajisjeve | | |
| Shitja e pasurive fikse | 0.00 | 0.00 |
| Mjete monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit | | |
| Mjetet monetare (të përdorura për) / nga veprimtaritë e shfrytëzimit | | |
| Fluksi i mjeteve monetare nga veprimtaritë investuese | | |
| Blerje e aktiveve afatgjata materiale | (0.00) | (0.00) |
| Te hyra nga shitja e aktiveve afatgjata materiale | | |
| Mjetet monetare të përdorura për veprimtaritë investuese | <u>(00)</u> | <u>(00)</u> |
| Flukse monetare nga veprimtaritë financuese | | |
| Parat e marra nga huamarrjet afatgjata | | |
| Rritja e kapitalit aksionar | 0.00 | 0.00 |
| Rezultati nga huate | 0 | 0 |
| Mjete monetare nga / (të përdorura për) veprimtaritë financuese | <u>0</u> | <u>0</u> |
| Pagesat e huase per huazimet e marra | (97,500) | (30,000) |
| Inkasimet nga huazimet e marra | 40,000 | (15,000) |
| Gjithsej pagesa per aktivitetet financuese | (57,500) | (45,000) |
| Rritja neto e mjeteve monetare | (449,429) | 460,485 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to në 1 Janar | <u>460,488</u> | <u>3</u> |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 Dhjetor (Shënim 4) | <u>11,059</u> | <u>460,488</u> |

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 5 deri 19.

“FC DRITA”SH.P.K

(Vlerat në EUR, përveçse kur është thënë ndryshe)

Pasqyra e Ndryshimeve ne Ekuitet per vitin qe përfundon
me 31 Dhjetor 2019

| | Kapitali aksionar | Fitimet e mbajtura | Rezervat e tjera | Gjithsej |
|------------------------------------|----------------------|-----------------------|---------------------|-----------------|
| | € | € | € | € |
| Gjendja më 1 janar 2018 | 20,000 | (58,498) | | (38,498) |
| Fitimi / (humbja) i/e vitit | | 37,565 | | 37,565 |
| Diferencat nga përkthimet valutore | | | | |
| Dividendat | | | | |
| Deponimet e kapitalit shtesë | | | | |
| Ndarja e rezervave | | | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 2018 | 20,000 | (20,933) | | (933) |
| Fitimi / (humbja) i/e vitit | | 20,933 | | 20,933 |
| Diferencat nga përkthimet valutore | | | | |
| Dividendat | | | | |
| Deponimet e kapitalit shtesë | | | | |
| Ndarja e rezervave | | | | - |
| Gjendja më 31 dhjetor 2019 | 20,000 | 0 | 0 | 20,933 |

Pasqyra e ndryshimeve në Ekuitet duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese që janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare në faqet 5 deri 19.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përvecse kur është thënë ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

“FC DRITA” SH.P.K. (që më poshtë do t'i referohemi si “FC DRITA” ose “Shoqëria”) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 22.07.2016 dhe është e regjistruar me nr unik 811186974 në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Agjensionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës në Ministri të Tregtisë dhe Industrisë.

Selia e regjistruar e Shoqërisë dhe vendi kryesor i aktivitetit është në Gjilan, Stadiumi i Qytetit p.n., Republika e Kosovës.

Aktiviteti kryesor i biznesit të Shoqërisë është aktiviteti sportiv ,kurse kapitali themelor i Shoqërisë ishte 20,000.00 € i regjistruar dhe paguar.

Shoqëria ka dy aksionare sipas Listes dhe Aneksit si dhe Informateve mbi biznesin ne ARBK.

Shoqëria gjatë vitit 2019 ka pasur mesatarisht 40 të punësuar. Drejtori i autorizuar menaxhon me Shoqerine.

2. Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiaire janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet e Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM. Këto pasqyra financiaire janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Pasqyrat Financiare janë pergaditur per vitet e perfunduara me 31 dhjetor 2019 dhe 2018. Te dhenat aktuale dhe karahasuese ne keto pasqyra financiaire janë te shprehura ne Euro, perderisa nuk ceket ndryshe. Kur eshte e nevojshme zerat krahasues janë harmonizuar konform ndryshimeve te vitit ne prezantim.

Pasqyrat financiaire janë përgatitur për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019 në baza akruale përvèç Rrjedhës së parashë.

2.1 Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiaire janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.2 Zbatimi i standardeve të reja dhe të ndryshuara

Në vitin aktual, Organizata ka zbatuar një numër të ndryshimeve në SNRF të publikuara nga Bordi i Standardeve Nërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të obligueshme dhe efektive për periudhën që fillon me ose pas datës 1 janar 2018.

2.2.1 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në standardet ekzistuese të cilat nuk janë ende efektive

SNRF 16 Lizingu

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretime përkatëse. SNRF 16 paraqet model gjithëpërfshirës për identifikimin e arranzhimeve për lizing dhe trajtimin kontabël për qiradhënsit dhe qiramarrësit. SNRF 16 bën dallimin në mes të kontratave për shërbime duke u bazuar në faktin nëse një pasuri e identifikuar kontrollohet nga konsumatori. Dallimet në mes të lizingut operativ (jasht bilancit) dhe lizingut finanziar (në bilanc) janë hequr për kontabilitetin e qiramarrësit dhe është zëvendësuar me modelin sipas të cilit e drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimi korrespondues duhet të njihen për të gjitha lizingjet nga qiramarrësi (dmth të gjitha në bilanc) përvèç për lizingjet afatshkura dhe lizingjet për pasuritë me vlerë të ulët.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përvetëse kur është thënë ndryshe)

SNRF është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019. Menaxhmenti ende pritet të vlerësojë në tërësi ndikimin e këtij standardi prandaj nuk është në gjendje të ofroj informata të kuantifikuara.

Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

2.3 Politikat e kontabilitetit

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

(a) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRFpër NVM kërkon që menaxhmenti të kryej gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të reportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Politikat e mëposhtme kontabël janë zbatuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

(a) Pasuritë afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha pasuritë afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar.

Kosto përfshinë shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e pasurisë.

Kosto e pasurive të ndërtuara nga vetë Kompania përfshinë koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e pasurisë në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar. Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të pasurive afatgjata materiale

(a) Pasuritë afatgjata material (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një pasurie materiale afatgjatë përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të pasurisë materiale afatgjatë, dhe njihen në fitim ose humbje. Kur pasuritë e rivlerësuara shiten, vlerat e përfshira në rezervë transferohen në fitimet e bartura.

(ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë materiale ose njihen si një pasuri më vete, sipas rastit, vetëm atëherë kur pritet me besueshmëri të lartë që në shoqëri do të rrjedhin përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të pasurive materiale afatgjata njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi nuk llogaritet për tokën dhe ndërtimet në proces. Përmirësimet në ambientet e marra me qira amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër ndërmjet jetës së dobishme dhe afatit të qirasë. Amortizimi për mjetet e tjera njihet në fitim ose humbje me metodën linerae për shpërndarjen e kostos ose vlerës së rivlerësuar deri në vlerën e mbetur përgjatë jetës së dobishme.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përveçse kur është thënë ndryshe)

Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Normat më poshtë janë përdorur për zhvlerësimin në periudhen aktuale dhe krahasuese:

| | 2019 | 2018 |
|-------------------------------------|------|------|
| Toka | - | - |
| Ndërtesa | 5% | 5% |
| Pajiset | 20% | 20% |
| Mjetet tjera motorike trasnportuese | 20% | 20% |
| Veturat dhe paisjet tjera | 20% | 20% |

(a) Pasuritë me qira

Qiratë ku Kompania bart në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi pasurinë janë klasifikuar si qira financiare. Në njohjen fillestare, pasuria e marrë me qira matet me vlerën më të vogël midis vlerës së drejtë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Pas njohjes fillestare, pasuria kontabilizohet në përputhje me politikën kontabël të zbatueshme për atë mjet.

Qiratë e tjera janë qira të zakonshme për të cilat pasuria e marrë me qira nuk njihet në pasqyrën e pozicionit financier të Shoqeri.

(b) Stoqet

Stoqet maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e stoqeve bazohet në parimin e mesatares së ponderuar dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e shndërrimit dhe kosto të tjera që lidhen me vënien e stoqeve në vendin dhe kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të përfundimit dhe kostot e vlerësuara që duhen për realizimin e shitjes.

(c) Instrumentet financiarë

Kompania mban vetëm instrumente financiarë jo-derivative, që përfshijnë njete monetare dhe ekuivalente me to, llogari të arkëtueshme, llogari të pagueshme, kreditë bankare. Instrumentet financiarë jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë jo-derivativë përshkruhet më poshtë.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, të tjera investime afatshkurtra me maturitet original tre muajose më pak nga data e pasqyrës së pozitës financiare, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Kompania në administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financier.

Kërkesa për arkëtim

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar të pakësuara për humbjet për zhvlerësimet.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përveçse kur është thënë ndryshe)

Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

Kreditë bankare huatë

Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe kreditë paraqiten me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë ndërmjet kostos dhe vlerës së riblerjes që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes në bazat e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumenta finanziarë të tjerë jo-derivative maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksioner i njihet me vlerën nominale.

(d) Zhvlerësimi

(i) Pasuritë financiare

Një pasuri financiare që nuk mbahet me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes vlerësohet në çdo datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi. Një pasuri financiare konsiderohet e zhvlerësuar nëse një evidencë objektive tregon se ka

ndodhur një ngjarje zhvlerësimi pas njohjes fillestare të pasurisë, dhe kjo ka patur një ndikim negativ në flukset e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare të pasurisë financiare, i cili mund të vlerësohet me besueshmëri.

Humbja nga zhvlerësimi i një pasurie financiare të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferençë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhave të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare, aktualizuar me normën fillestare të interesit efektiv.

(d) Zhvlerësimi (vazhdim)

Pasuritë financiare të cilat janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e pasurive financiare vlerësohet bashkarisht në grupe që mbartin karakteristika të ngashme risku. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Një humbje zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Anulimi njihet në fitim ose humbje.

(ii) Pasuritë jo-financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Kompanisë, përveç pasurive materiale afatgjata të investuara, stoqeve dhe pasurive tatinore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencia për zhvlerësim. Nëse ka evidencia të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një pasurie tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël identifikueshmë i pasurive që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga pasuritë dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përveçse kur është thënë ndryshe)

Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Vlera e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare janë aktualizuar duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë.

Përsa i përket pasurive të tjera, një humbje për zhvlerësim anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njojur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(e) Njohja e të ardhurave

E ardhura nga shitja e mallrave matet me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë, neto nga kthime dhe zbritje tregtare. E ardhura njihet kur risqet dhe përfitimet lidhur me pronësinë janë transferuar tek blerësi dhe është e mundshme që përfitimet ekonomike do të merren, kostot që lidhen me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme dhe Kompania

Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

nuk është e përfshirë më në menaxhimin e mallrave dhe produkteve të shitura dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme. Nëse mendohet me besueshmëri të lartë se do të aplikohen zbritje dhe vlera mund të matet me besueshmëri të lartë, atëherë zbritja njihet si zvogëlim i të ardhurës në momentin kur njihen shitjet.

Te hyrat nga kontratat e ndërtimit janë njojur me vlerën e drejtë të konsideratës së arkëtar ose të arkëtueshme. Te hyrat nga kontratat e ndërtimit mund të rriten ose zvogëlohen nga një periudhë në tjetrën përsye se ato ndikohen nga një numër pasigurish që varen nga rrëthanat në të ardhmen. Si rjedhojë, vlerësimet për të hyrat janë rishikuar pas ndodhjes së ngjarjeve ose zgjidhjes së pasigurive.

(e) Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Kur rezultati (përfundimi) nga një kontratë e ndërtimit mund të vlerësohet me besueshmëri, të hyrat dhe kostot që ndërlidhen me ato të hyra duhet të njihen si të hyra dhe shpenzime respektive duke ju referuar shkallës së kompletimit të aktivitetit të kontratës në fund të periudhës së raportimit. Një humbje e pritur në një kontratë ndërtimi duhet të njihet menjëherë si shpenzim në pasqyrën e fitimit dhe humbjës.

(f) Përfitimet e punonjësve

Kontributet pensionale të detyrueshme

Kompania paguan vetëm kontributet për kontributet pensionale të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për përcaktimin e kufirit ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Kompanisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Pushimet vjetore të papaguara

Kompania njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me pushimet vjetore që pritet të paguhën në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përveçse kur është thënë ndryshe)

Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(g) Pagesat e qirasë

Pagesat e kryera për qiranë e zakonshme janë ngarkuar në fitim ose humbje në mënyre lineare gjatë periudhës së qirasë. Pagesë motivimi marrë nga qiradhënësi njihen si pjesë integrale e shpenzimit Gjithsej gjatë periudhës së qirasë.

(h) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga llogaritë në banka dhe fitimet nga kursi i këmbimit që njihen në fitim ose humbje. Të ardhurat nga interesit njihen kur ai përfitohet duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Të gjitha kostot e huave njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(i) Tatim në të ardhura

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vtit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njojur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshmërri të vtit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshmërri përvitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njojur për diferençat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur bazuar në metodën e realizimit ose kompensimit të vlerave kontabël të pasurive dhe detyrimeve, duke përdorur shkallë tatimore që janë në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën raportimit.

(i) Tatim në të ardhura (vazhdim)

Një pasuri tatimore e shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshmërri i ardhshëm do të jetë i disponueshmërri kundrejt të cilët të mund të përdoren humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditimet tatimore të papërdorura. Pasuria tatimore e shtyrë zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

(j) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Pasuritë dhe detyrimet jo- monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje, përveç diferençave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje nëse ka, të cilat njihen në të ardhura të tjera përbledhëse.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përvecse kur është thënë ndryshe)

Përbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(k) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë, i cili supozon realizimin e pasurive dhe përbushjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit.

3. Menaxhimi i riskut financiar

3.1 Risku kreditor

Risku kreditor paraqet riskun që pala tjetër të dështoj në kryerjen e obligimeve kontraktuale që rezulton në humbje financiare të Shoqërisë. Shoqëria ka adoptuar një politikë për të kontraktuar vetëm palët e besueshme dhe të siguroj dëshmi të mjaftueshme, për të zvogëluar rrezikun e humbjes financiare nga dështimi në kryerjen e pagesave. Shoqereria siguron që njeh vetëm të arkëtueshmet nga shoqëritë të mirë-formuara në Kosovë.

3.2 Risku i tregut

Risku i tregut është risku i cili ndryshon me ndryshimin e çmimeve të tregut, siç janë ndryshimi i kursit valuator i jashtëm dhe i normave të interesit që do të ndikojnë në të hyrat e Shoqërisë apo vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare të saj. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është menaxhimi dhe kontrollimi i ekspozimit të riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, gjatë optimizimit të kthimit. Përderisa nuk ka transaksione materiale në valutën e huaj dhe përderisa nuk ka interes në fondet e huazuara nga institucionet financiare lokale dhe të jashtme në datën e pozicionit financiar, Shoqëria nuk ekspozohet ndaj çfarëdo ndryshimi të kursit të këmbimit dhe rrezikut të normave të interesit.

| | 31 Dhjetor 2019 | 31 Dhjetor 2018 |
|-------------------------------|--------------------|--------------------|
| Pasuritë | | |
| Paraja e gatshme dhe në bankë | 11,059 | 460,488 |
| Totali | 11,059 | 460,488 |

3.3 Risku i likuiditetit

Përgjegjësia themelore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit i takon Bordit te drejtoreve. Menaxhimi i matur i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, disponueshmëri të fondeve përmes lehtësirave për kredi dhe mundësisë për t'i mbledhur në kohën e duhur, brenda kushteve të shumave të vendosura për shkak të konsumatorëve. Shoqëria menaxhon riskun e likuiditetit duke mbajtur rezerva nga huaziemt e dhena dhe duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme planifikimin dhe rrjedhën aktuale të parasë, dhe duke koordinuar profilet e maturitetit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Tabelat në vijim paraqesin maturitetet kontraktuale të mbeturat të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë. Tabelat përgatiten në baza të rrjedhave të parasë të paskontuara të detyrimeve financiare.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përvetëse kur është thënë ndryshe)

31 Dhjetor 2019

| | Qarkulluese | | Jo - qarkulluese | |
|---|-------------------------|----------------------------|----------------------------|-------------------------|
| | Deri në 1 vit (Euro) | 1 deri 2 vite (Euro) | 2 deri 5 vite (Euro) | Mbi 5 vite (Euro) |
| Pasuritë financiare | | | | |
| Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj | 11,059 | - | - | - |
| Llogaritë e arkëtueshme | 3,600 | | | |
| Kerkesat per huazime | 112,500 | - | - | - |
| Totali i pasurisë | 127,159 | - | - | - |
| Detyrimet financiare | | | | |
| Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera | 110,192 | | | - |
| Totali i detyrimeve financiare | 110,192 | | | - |

31 Dhjetor 2018

| | Qarkulluese | | Jo - qarkulluese | |
|---|-------------------------|----------------------------|----------------------------|-------------------------|
| | Deri në 1 vit (Euro) | 1 deri 2 vite (Euro) | 2 deri 5 vite (Euro) | Mbi 5 vite (Euro) |
| Pasuritë financiare | | | | |
| Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj | 460,488 | - | - | - |
| Llogaritë e arkëtueshme | 5,450 | | | |
| Kerkesat per huazime | 15,000 | - | - | - |
| Totali i pasurive financiare | 480,938 | - | - | - |
| Detyrimet financiare | | | | |
| Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera | 486,304 | | | - |
| Totali i detyrimeve financiare | 486,304 | | | - |

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përvetëse kur është thënë ndryshe)

Instrumentet financiare që nuk paraqiten në vlerën e drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe vlerat e drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare që nuk paraqiten në Pasqyrën e pozitës financiare në vlerën e tyre të drejtë:

| | Vlera bartëse | Vlera e drejtë | Vlera bartëse | Vlera e drejtë |
|---|----------------|----------------|----------------|----------------|
| | 2019 | 2019 | 2018 | 2018 |
| Pasuritë financiare | | | | |
| Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj | 11,059 | 11,059 | 460,488 | 460,488 |
| Llogaritë e arkëtueshme | 3,600 | 3,600 | 5,450 | 5,450 |
| Kerkesat per huazime | 112,500 | 112,500 | 15,000 | 15,00 |
| Totali i pasurive financiare | 127,159 | 127,159 | 480,938 | 480,938 |

Detyrimet financiare

| | | | | |
|---|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera | 110,192 | 110,192 | 486,304 | 486,304 |
| Totali i detyrimeve financiare | 110,192 | 110,192 | 486,304 | 486,304 |

4. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si me poshtë:

| | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2018 |
|------------------------|-----------------|-----------------|
| Vlera e parase në arkë | 0 | 0 |
| Vlera në banke | 11,059 | 460,488 |
| Gjithsej | 11,059 | 460,488 |

Mjetet monetare mbahen ne banka vendore dhe ne euro sipas marreveshjes.

5. Lloagaritë e arkëtueshme

Gjëndja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përfaqëson kërkesat për arkëtim nga shitja:

| | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|-------------------------|-----------------|-----------------|
| Llogarite e arkëtueshme | 3,600 | 5,450 |
| | 3,600 | 5,450 |

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përvecse kur është thënë ndryshe)

6. Huazimet e dhena

Gjëndja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përfaqëson kërkuesat për arkëtim nga shitja:

| | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2018 |
|-------------------------|------------------------|------------------------|
| Llogarite e arketueshme | 112,500 | 15,000 |
| | 112,500 | 15,000 |

7. Pasurite afatgjate

Pasurite afatgjate materiale me 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë sa me poshtë:

| | Ndertesa | Pajisje Informatike | Pajisje zyre | Automjete | Makineri | Total |
|---------------------------|----------|------------------------|-----------------|-----------|----------|-------|
| Kosto | | | | | | |
| Më 1 Janar 2018 | | | 7,000 | | | 7,000 |
| Shtesat | | | | | | |
| Pakësime | | | | | | |
| Nxjerrje jashtë përdorimi | | | | | | |
| Më 31 dhjetor 2018 | | | 7,000 | | | 7,000 |
| Shtesat | | | | 7,000 | | 7,000 |
| Pakësime | | | | | | |
| Më 31 dhjetor 2019 | | | 7,000 | | | 7,000 |
| Amortizimi i akumuluar | | | | | | |
| Më 1 janar 2018 | | | 1,167 | | | 1,167 |
| Amortizimi për vitin | | | 1,400 | | | 1,400 |
| Pakësime | | | | | | |
| Nxjerrje jashtë përdorimi | | | | | | |
| Më 31 dhjetor 2018 | | | 2,567 | | | 2,567 |
| Amortizimi për vitin | | | 1,400 | | | 1,400 |
| Pakësime | | | | | | |
| Më 31 dhjetor 2018 | | | 3,967 | | | 3,967 |
| Vlera kontabël neto | | | | | | |
| Më 1 janar 2018 | | | 5,833 | | | 5,833 |
| Më 31 dhjetor 2018 | | | 4,433 | | | 4,433 |
| Më 31 dhjetor 2019 | | | 3,033 | | | 3,033 |

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përvècse kur është thënë ndryshe)

8. Llogarite e pagueshme tregtare

Llogarite e pagueshme tregtare me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si me poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|-----------------------|-----------------|-----------------|
| Llogarite e pagueshme | 17,280 | 1,409 |
| | <hr/> <hr/> | <hr/> <hr/> |
| | 17,280 | 1,409 |

9. Detyrime per paga dhe tatime

Detyrimet e tjera me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si me poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|------------------------------------|-----------------|-----------------|
| Detyrime per paga te punesarve | 3,925 | 8,790 |
| Detyrime per tatime dhe kontributë | <hr/> | <hr/> |
| | 3,925 | 8,790 |

10. E hyra e shtyrë

Detyrimet e tjera me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si me poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|--------------------------|-----------------|-----------------|
| E hyra e shtyre nga UEFA | 48,987 | 476,105 |
| | <hr/> | <hr/> |
| | 48,987 | 476,105 |

11. Huazimet

Detyrimet e tjera me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si me poshtë:

| | 31 dhjetor 2019 | 31 dhjetor 2018 |
|-------------------------|-----------------|-----------------|
| Huazimet nga aksionaret | 40,000 | 0 |
| | <hr/> | <hr/> |
| | 40,000 | 0 |

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përveçse kur është thënë ndryshe)

12. Të ardhurat

Të ardhurat nga shitja ne vitin 2019 dhe vitin 2018 perfshijnë :

| | 2019 | 2018 |
|---|---------|---------|
| Te hyrat nga marketing dhe sponzorizimi | 2,542 | 19,288 |
| Te hyrat nga te drejtat televizive | 25,000 | 49,500 |
| Te hyrat nga donacionet | 10,000 | 2,000 |
| Te hyrat nga akademia | 487 | 1,652 |
| Te hyrat nga biletat | 1,441 | 1,190 |
| Te hyrat nga shpallja kampion | | 30,000 |
| Te hyrat nga UEFA | 14,350 | 553,895 |
| Te hyrat e shtyra | 427,118 | |
| | 480,938 | 657,525 |

13. Kostoja e sherbimeve

Kostoja e sherbimeve është si me poshtë:

| | 2019 | 2018 |
|--------------------------------------|--------|---------|
| Shpenzimet e Paisjeve Sportive | 15,229 | 10,481 |
| Shpenzimet e akomodimit | 31,271 | 69,821 |
| Shpenzimet e udhetimit | 9,461 | 69,554 |
| Shpenzimet organizimi te ndeshjeve | 980 | 12,350 |
| Shpenzimet e sigurimit te ndeshjeve | 4,750 | 1,572 |
| Shpenzimet e Referimit | 500 | 5,970 |
| Shpenzimet e licencave | 2,700 | 500 |
| Shpenzimet e transferit të lojtarëve | 12,000 | 180 |
| Shpenzimet e ushqimit te lojëtarëve | 7,706 | 8,512 |
| Shpenzimet e shtypjes se biletave | 176 | 381 |
| Gjithsej | 84,773 | 179,321 |

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përvetëse kur është thënë ndryshe)

14. Shpenzime personeli

Kostot e personelit paraqitet si me poshtë:

| | 2019 | 2018 |
|--|---------------|---------------|
| Shpenzimet e pagave lojtareve | 205,394 | 269,590 |
| Shpenzimet e page te shtabit teknik | 47,230 | 36,820 |
| Shpenzimet e pagave staf administrativ dhe tjere | 63,565 | 73,057 |
| Shpenzimet e kontributeve pensionale | 12,347 | 17,391 |
| | <hr/> 328,536 | <hr/> 396,858 |

Kontributet pensionale paguhen vetem per banor te perhershëm ne rexhistrin civil te Kosovës.

15. Shpenzimet administrative

| | 2019 | 2018 |
|---------------------------------------|--------|--------|
| Shpenzimet e kontabilitetit | 6,000 | 6,000 |
| Shpenzimet e Auditimit | 1,200 | 1,200 |
| Shpenzimet e zyres dhe telefonit | 935 | 4,105 |
| Shpenzimet e provizioneve | 1,075 | 1,807 |
| Shpenzimet e Reklames | 4,778 | 4,719 |
| Shpenzimet e qerase | 0 | 2,903 |
| Shpenzimet e mirëmbajtjes se webfaqes | 1,101 | 1,017 |
| Shpenzimet mjekesore | 3,648 | |
| Shpenzimet e donacioneve | 2,500 | |
| Gjithsej | 21,237 | 21,751 |

16. Shpenzimet operative

| | 2019 | 2018 |
|---------------------------------------|--------|--------|
| Shpenzimet e deriveve | 6,728 | 10,545 |
| Shpenzimet e mirëmbajtjes | 3,356 | 1,544 |
| Shpenzimet e sigurimit te automjeteve | 1,046 | 1,105 |
| Shpenzimet tjera operative | 7,876 | 7,435 |
| Shpenzimet e jashtzakonshme | 5,033 | 0 |
| Gjithsej | 24,059 | 20,629 |

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përveçse kur është thënë ndryshe)

17. Tatimi mbi fitimin

Të njoitura në pasqyrën e të ardhurave:

| | 2019 | 2018 |
|---|----------------|----------------|
| Fitimi para tatimit: | <u>20,933</u> | <u>37,565</u> |
| 1.Tatimi fillestar me normë standarde | 10% | 2,093 |
| 2.Shpenzimet e pazbritshme: | | 3,756 |
| a.Shpenzimet e borxhit te keq | | |
| b.Shpenzimet per vonesa ne pagese dhe mungese fature | | |
| 3.Tatim fitim shtesë nga rivleresimi i të ardhurave të tatueshme nga autoritetet fiskale (2 * 10%) | 10% (2,093) | <u>(5,849)</u> |
| Tatimi ne fitim (1+3) | <u>(2,093)</u> | <u>(2,093)</u> |

Tatim fitim zbritet per humbjet e bartura nga vitet e kaluara mbi bazen e legjisacionit tativore ne fuqi.

17.1. Humbjet e bartura

| | 2019 | 2018 |
|---|-----------------|-----------------|
| Fitimi i vitit | <u>20,933</u> | <u>37,565</u> |
| Humbjet të bartura | <u>(20,933)</u> | <u>(58,498)</u> |
| Fitimi/ Humbja e bartur ne vitet ne vijim | <u>(0)</u> | <u>(20,933)</u> |

Humbja tativore bartet deri ne 4 vite pas vitit kur ka ndodhur .

18. Palët e lidhura

Për vitin raportues 2019 transaksionet me persona te lidhur janë:

31 Dhjetor 2019

| Subjekti | Huazimet e marra | Huazimet e dhena |
|-------------|------------------|------------------|
| Aksionari 1 | 40,000 | |
| Aksionari 2 | | 30,000 |

19. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël

Menaxhmenti diskuton në mbledhjet e tyre të rregullta për zhvillimin, zgjedhjen dhe shpalosjen e politikave dhe vlerësimeve të rëndësishme kontabël të Kompanise si dhe aplikimin e ketyre politikave dhe vlerësimeve. Shoqeria bën vlerësimë dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financier. Vlerësimet dhe gjykimet vazhdimit vlerësohen dhe janë të bazuara në planifikim dhe faktorë tjerë duke përfshirë edhe pritet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave të caktuara.

“FC DRITA”SH.P.K

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

(Vlerat në EUR, përveç kur është thënë ndryshe)

20. Zotimet dhe Kontigjentet

Zotimet

Nuk ka zotime më 31 Dhjetor 2019 përveç marrëveshjes për mirëmbajtje të stadionit me Komunë.

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2019 nuk është illogaritur asnjë provizion për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i kompanisë, rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Kompanisë, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmeti i Kompanisë beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

21. Kapitali themeltar

Shoqeria posedon kapital themeltar prej 20,000.00€ te regjistruar ne Ministrinë e Tregëtisë me dy aksionar si më poshtë:

1. Valon Murseli me pjesen e kapitalit prej 10,000.00€ dhe
2. Flamur Bunjaku, me pjesen e kapitalit prej 10,000.00€

22. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka pasur ndonje ngjarje pas përfundimit te periudhes raportuese qe vlen te shpaloset.

23. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga menaxhmenti më 29.02.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/ MINISTARSTVO ZA FINANSIJE/
MINISTRY OF FINANCE

KKRF - Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar
KSFI - Kosovski Savet za Financisko Izveštavanje
KCFR - Kosovo Financial Reporting Council

ÇERTIFIKATË E PRAKTIKËS

Kjo Çertifikatë vërteton se

PRACTICNO UVERENJE

Ova Uverenja potvrđuje da je

PRACTICING CERTIFICATE

This Certificate is to confirm that

Nr. 94
Fahri Breznica

Më 29.01.2020 është certifikuar si Auditor ligjor në përputhje me nenin 30 të Ligjit Nr. 06/L-032 dhe UA 2019/01 Mbajtësit të kësaj certifikate i ipen të gjitha të drejtat për të kryer auditime siq parashitet me Ligj dhe mban titullin Auditor Ligjor.

Dana 29.01.2020 sertifikovan je kao pravni Revizor u skladu sa članom 30 .zakona br. 06/L-032 I AU 2019/01.Nosiocu ove sertifikata daju i sva prava da sprovede reviziju u skladu sa zakonom I dobija se zvanje pravni revizor.

On 29.01.2020 was certified as an Legal Auditor in accordance with article 30 of Law 06/L-032 and AI 2019/01. Holder of this certificate is hereby granted all rights to conduct audit as set forth in Law and is titled a Legal Auditor.

Luljeta Shyti
U.D Udhëheqës i sekretariatit
Rukovodilac sekretariata
Head of the secretariat



Afrim Maloku
Kryesues i Këshillit
Presedavajući Saveta
Chairman of the Council